



Prishtinë, 15.10.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1059\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 8 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të Matjes të datës 28 qershor 2018,

në seancën e mbajtur me datë 15.10.2018, nxori këtë:

**VENDIM**

- I. **APROVOHET** amendamenti i dokumentit “Kodi i Matjes” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

**Arsyetim**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.06.2018 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e dokumentit “Kodi i Matjes” të harmonizuar me legjislacion në fuqi. Në këtë kuadër janë shtuar disa pika si edhe është bërë përshtatja e termave sipas legjislacionit në fuqi, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- o ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amendamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO.
- o Pas përfshirjes së të gjitha komenteve dhe finalizimit të dokumentit, KQKO me datë 03.08.2018 ka dërguar dokumentin “Kodi i Matjes” në ZRRE me kërkesën për aprovimin e amendamentimit të tij.
- o Pas vlerësimit të kërkesës nga KQKO për amendamentim, ZRRE ka aprovuar amendamentimin e dokumentit “Kodi i Matjes”.
- o Të gjitha dispozitat tjera të dokumentit “Kodi i Matjes” do të mbesin në fuqi.
- o Dokumenti “Kodi i Matjes” ver. 1.3 shfuqizon dokumentin “Kodi i Matjes” ver. 1.2.